



MINISTRIA E DREJTËSISË

# VJETARI STATISTIKOR 2006

Tiranë, 2007

***Sektori i Statistikës së Unifikuar  
Teknologjisë së Informacionit, Studimeve dhe Bibliografisë***

**Botim i Ministrisë së Drejtësisë  
Viti i pestë i botimit**

**Punuan:**

**Muhamet HOXHA  
Shef i Sektorit të Statistikës**

**Matilda HOXHA  
Specialiste në Sektorin e Statistikës për çështjet penale  
Evis XHAXHA  
Specialiste në Sektorin e Statistikës për çështjet civile**

**Kompjuterizoi  
Matilda HOXHA**

**© i këtij botimi Qendra e Publikimeve Zyrtare**

**LËNDA**

|                                 |   |
|---------------------------------|---|
| Fjala e Ministrit të Drejtësisë | 5 |
| Hyrja                           | 7 |

**KREU I**

|                                                                                     |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Statistika për çështjet penale & civile të gjykuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë | 12 |
| Statistika e çështjeve penale të gjykuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë           | 13 |
| Dinamika e çështjeve penale                                                         | 14 |
| Mënyra e përfundimit të çështjeve penale                                            | 15 |
| Çështjet penale të gjykuara                                                         | 16 |
| Seritë dinamike të kërkesave penale                                                 | 19 |
| Shpejtësia e gjykimit                                                               | 21 |
| Krahasimet i dinamikës së çështjeve të përfunduara në Gjykatat e Shkallës së Parë   | 23 |

**KREU II**

|                                                                                                                           |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Klasifikimi i çështjeve penale të gjykuara në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe ankimimet                                   | 25 |
| Seritë dinamike që tregojnë ankimimet në Gjykatat e Shkallës së Parë                                                      | 28 |
| Statistikat për çështjet penale të gjykuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë sipas figurës së veprës penale të Kodit Penal | 31 |
| Mënyra e përfundimit të çështjeve penale                                                                                  | 42 |
| Klasifikimi i të dënuarve për krime në Gjykatat e Shkallës së Parë                                                        | 43 |
| Të dënuarit sipas rrethëve gjyqësore                                                                                      | 47 |
| Masa e dënimit sipas veprave penale                                                                                       | 49 |

**KREU III**

|                                                            |    |
|------------------------------------------------------------|----|
| Shpërndarja e kriminalitetit bazuar në çështjet e gjykuara | 57 |
| Studimi i koeficientit të kriminalitetit                   | 59 |

**KREU IV**

|                                                                                                |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Çështjet e gjykuara për krime në Gjykatat e Shkallës së Parë sipas kodit penal ushtarak        | 62 |
| Çështjet e gjykuara për kundërvajtje në Gjykatat e Shkallës së Parë sipas kodit penal ushtarak | 63 |
| Statistika e përfundimit të çështjeve penale ushtarake (të dënuarit & shpejtësia e gjykimit)   | 65 |

**KREU V**

|                                                           |    |
|-----------------------------------------------------------|----|
| Çështjet e gjykuara për të mitur                          | 70 |
| Të dënuarit e mitur sipas veprave penale                  | 71 |
| Të dënuara femra & veprat penale për të cilat janë dënuar | 72 |

## **KREU VI**

|                                                                                          |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim                                            | 75 |
| Aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore | 78 |

## **KREU VII**

|                                                                |    |
|----------------------------------------------------------------|----|
| Ngarkesa e gjyqtarëve sipas rretheve gjyqësore                 | 80 |
| Shpërndarja e volumit të punës në Gjykata e Rretheve Gjyqësore | 82 |

## **KREU VIII**

|                                                                |     |
|----------------------------------------------------------------|-----|
| Statistika e çështjeve penale të shqyrtuara nga Apelet         | 90  |
| Mënyra e përfundimit të çështjeve penale në Gjykatat e Apeleve | 95  |
| Çështjet penale të gjykuara nga Gjykata e Lartë                | 106 |

## **KREU IX**

|                                                                           |     |
|---------------------------------------------------------------------------|-----|
| Statistikat e çështjeve civile të gjykuara në Gjykatat e Shkallës së Parë | 113 |
| Statistikat e çështjeve civile të përfunduara                             | 114 |
| Çështjet civile me/pa palë kundërshtare                                   | 115 |
| Çështjet civile të gjykuara sipas rretheve gjyqësore                      | 117 |
| Shpejtesia e gjykimit të çështjeve civile                                 | 125 |
| Ankimet e çështjeve civile të gjykuara në Gjykatat e Shkallës së Parë     | 128 |
| Zgjidhjet martesore                                                       | 130 |

## **KREU X**

|                                                                  |     |
|------------------------------------------------------------------|-----|
| Statistikat e çështjeve civile të gjykuara nga Gjykatat e Apelit | 133 |
| Mënyra e përfundimit të çështjeve civile në Gjykatat e Apelit    | 135 |
| Çështjet civile të shqyrtuara në Gjykatën e Lartë                | 147 |

## **KREU XI**

|                                                                                         |     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Statistika analitike për çështjet penale & civile sipas Gjykatave të Rretheve Gjyqësore | 154 |
|-----------------------------------------------------------------------------------------|-----|

## **KREU XII**

|                                                                     |     |
|---------------------------------------------------------------------|-----|
| Statistikat për procedimet penale dhe dinamikën e tyre në Prokurori | 185 |
| Tabela e ekzekutimit të vendimeve penale sipas rretheve             | 191 |

## **KREU XIII**

|                                                                  |     |
|------------------------------------------------------------------|-----|
| Statistikat e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Gjyqësor | 195 |
|------------------------------------------------------------------|-----|

## **Të dashur studiues!**

Ju që shfletoni këtë vjetar statistikor, që hulumtoni nëpër të dhënat e tij, që studioni e krahasoni statistikën, apo thelloni a rivlerësoni njohjen tuaj mbi drejtësinë, padiskutim që e bëni këtë për shkak të vetëdijes suaj se DREJTËSIA është zemreku i shoqërisë.

Juve – si ministër i Drejtësisë dhe në emër të të gjitha institucioneve që formojnë sistemin – dëshiroj t’ju falenderoj për zemërsisht për ndjeshmërinë dhe interesim për Drejtësinë, për kauzën tonë.

Ky vjetar që po merrni sot në dorë ju shfaq me gjuhën e statistikës dhe të shifrave gjithë produktin një vjeçar të gjyqësorit, prokurorisë, përmbarimit dhe sistemit të burgjeve, referencë e sigurtë për volumin e punën që ka përballuar sistemi, por edhe indikacioni i rëndësishëm për kualitetin e saj.

Sigurisht që drejtësia në Shqipëri nuk është se funksionon në perfeksion, por nuk është as pa shpresë. Si ministër i Drejtësisë uroj që, si studiues të vëmendshëm, shenjat e shpresës t’i qëmtoni edhe nëpërmjet këtyre statistikave pse jo uroj që këto shenja shprese t’ju prijnë rrugën në nxitje, përvijim, mbështetje dhe kultivimin e vizionit tuaj, vizionit tonë për reformën e sistemit të drejtësisë. Sepse zemreku i shoqërisë ka nevojë të rrahë me ritmin e kohës, ka nevojë të çlirojë pafundësisht drejtësi.

Me besim të plotë tek ju dhe Drejtësia,

**Ilir Rusmali**





## H Y R J A

Në Ministrinë e Drejtësisë që me krijimin e saj grumbullohen, përpunohen dhe jepet informacion për të dhënat statistikore në fushën e drejtësisë, ndërsa këto 5 vitet e fundit është botuar vjetari statistikor si i vetmi botim i këtij lloji.

**Qëllimi ynë** në këtë botim është krijimi i një statistike të unifikuar për drejtësinë, ashtu si kërkohej shprehimisht në ligjin Nr. 8678 datë 14/05/2001 **“Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”**, i ndryshuar. Kjo është realizuar nëpërmjet grumbullimit të informacionit nga më shumë se një burim dhe krijimit të një situate ku të dhënat të interferohen duke verifikuar saktësinë e tyre. Kështu p.sh. të dhënat e marra nga Prokuroria e Përgjithshme për çështjet e dërguara për gjyq ballafaqohen me çështjet e ardhura të reja për gjykatën, ku merren në konsideratë edhe ato çështje të ardhura në gjykatë me ankim nga i dëmtuari akuzues, informacioni për urdhërat e ekzekutimit që jep prokuroria ballafaqohet me të burgosurit e rinj të ardhur në burgje ose çështjet e reja nga përmbarimi sipas rastit konkret; të dhënat për ankime merren nga tre shkallët e gjykatave dhe konkludohet për saktësinë e tyre.

Në disa raste vërehet një luhajtje në këto të dhëna që rrjedh si nga afatet proceduriale të komunikimit dhe lëvizjes së çështjeve ashtu edhe nga ndonjë gabim njerëzor në hedhjen e të dhënave, por të tilla mospërputhje janë me amplitudë të vogël.

**Burimi kryesor** në sigurimin e informacionit statistikor janë Gjykatat e Shkallës së Parë, Gjykatat e Apeleve dhe Gjykata e Lartë. Marrëdhëniet me këto institucione krahas detyrimeve ligjore nëpërmjet Ligjit për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor dhe Ligjit për Prokurorinë, janë rregulluar nëpërmjet akteve nënligjore si urdhëra dhe udhëzime të Ministrit të Drejtësisë, ku në fuqi janë **Udhëzimi nr.99, datë 07/01/2002 “Për plotësimin e të dhënave statistikore”** dhe **Udhëzimi nr. 324, datë 21/01/2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 99 datë 07/01/2002”**. Materiali statistikor sillet në Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet formularëve të plotësuar me të dhënat sipas Udhëzimeve përkatëse të Ministrit të Drejtësisë. Si rregull ky informacion plotësohet nga kancelari i gjykatës ose nën kujdesin e tij dhe kontrollohet nga kryetari i gjykatës.

**Burim tjetër i rëndësishëm** statistikor që shërben për pasqyrimin e të dhënave lidhur me hetimet paraprake, dinamikën e tyre dhe dërgimin e çështjeve për gjykim është **evidenca statistikore që Prokurori i Përgjithshëm sjell periodikisht në Ministrinë e Drejtësisë** dhe që realizohet në zbatim të ligjeve organik të dy institucioneve.

**Drejtoritë e Përgjithshme të Burgjeve dhe të Përmbarimit** mbyllin ciklin e grumbullimit të të dhënave për ekzekutimin e vendimeve penale dhe civile, duke plotësuar në tërësi të gjithë lëndën e parë me të cilën sektori i Statistikës së Unifikuar Teknologjisë së Informacionit Studimeve dhe Bibliografisë në Ministrinë e Drejtësisë ballafaqon dhe hedh të dhënat, operon me to për të hartuar informacionin përfundimtarë të statistikës së unifikuar, model të cilin po e paraqesim nëpërmjet këtij vjetari.

Vlen të theksohet se informacionet dhe botimet statistikor të INSTAT-it sidomos regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë kanë shërbyer jo vetëm si përvojë dhe metodologji, por edhe si burim i freskët informacioni me të cilat bëhet i mundur përcaktimi i shumë parametrave dinamikë që shprehin fenomene e dukuri specifike të mjediseve heterogjene. Me shumë interes në këtë kuadër është ndihma që jepet nga shfrytëzimi i këtij informacioni për studimin e shpërndarjes së kriminalitetit nëpërmjet përcaktimit të koeficientit të kriminalitetit për çdo rreth gjyqësor duke u dhënë gjyqtarëve të dhëna të domosdoshme që shërbejnë për politikën penale të dënimit dhe strukturave të tjera që merren me luftën ndaj krimit një orientim më shumë për llojin, volumin dhe strukturën e krimit në Shqipëri.

Studimi statistikor i fenomeneve dhe proceseve juridike ashtu si çdo studim i përgjithshëm statistikor kalon në tri faza:

1. Në vrojtim statistikor
2. Në përmbledhjen dhe grupimin e të dhënave
3. Në fazën e përpunimit dhe të analizës

Në këtë kontekst për lehtësi në kuptimin e materialit përfundimtar që kemi hartuar sqarojmë se jemi në kushtet e vrojtimit statistikor **me zgjedhje** gjë që bën të mundur të mblidhen, grupohen, analizohen dukuritë **tipike** dhe **esenciale**, psh. llojet e çështjeve penale, paditë dhe kërkesat civile të shqyrtuara, mënyra e përfundimit dhe shpejtësia e gjykimit, politika e dënimit etj , por mund të mos gjenden të dhëna për të gjitha alternativat e dënimit me burgim etj. që në praktikën gjyqësore zbatohen më rrallë.

Duhet të kemi të qartë që duke e konsideruar tipiken dhe esencialen në dialektikën e saj është e mundshme që fenomene të tilla juridike e të tjera si këto të gjejnë dritën e shqyrtimit dhe studimit statistikor për të ardhmen.

Lehtësirat që krijon përdorimi i teknologjive të reja të komunikimit dhe informacionit, për sa i përket shkëmbimit të informacionit midis gjykatave të ndryshme dhe këtyre të fundit me Ministrinë e Drejtësisë do të përbejë një prioritet për të ardhmen dhe do të krijojë mundësinë e thithjes së gjithë sasisë së informacionit statistikor.

Në grupimin dhe përmbledhjen e materialit statistikor jemi përpjekur të bëjmë kujdes në ndarjen e kolektivitetit në grupe homogjene, d.m.th. bashkimin në grupe (klasa) të së njëjtës gjini e të të njëjtit tip duke u bazuar në karakteristika të përbashkëta të tyre si psh ndarjen e çështjeve penale në krime dhe kundërvajtje penale ; ndarjen e çështjeve civile në padi dhe kërkesa dhe akoma me tej në nën klasa si civile në përgjithësi, familjare, administrative, tregtare. Me interes është edhe kombinimi i grupimit kualitativ me atë kuantitativ për fenomenet juridike të studiuara.

Në këtë vjetar statistikor ndeshim edhe analiza e konkluzione të dukurive të veçanta të shoqëruara me paraqitje grafike ose me seri dinamike për rrethe gjyqësore, shkallë të ndryshme të gjyqësorit, por



disa herë jepet edhe material bruto nga i cili mundet të veçohet elementi statistikor për të cilin interesohet përdoruesi i këtij informacioni.

### **Spektri i përdoruesve të këtij informacioni është i larmishëm nga pikëpamja profesionale.**

Ky vjetar shërben për vendimarrje, për qëllime studimore dhe për informim të publikut. Përdoruesit e tij janë autoritetet drejtuese të institucioneve që menaxhojnë problemet e drejtësisë, organizmat e ndryshme ndërkombëtare, personalitete të shkencës dhe studentë të fakultetit të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës, gazetarë të medias së shkruar dhe audiovizive si dhe publiku në përgjithësi. Me interes është edhe domosdoshmëria që kanë kryetarët e gjykatave, kancelarët, dhe gjyqtarët për njohjen e realitetit të shifrave e fakteve më tej se gjykata e tyre. Në këto kushte ka qënë e nevojshme pajisja e vjetarit me sqarime për terma të veçanta juridik dhe statistikor më të përdorshëm të cilat janë paraqitur dhe në gjuhën angleze.

Në këtë vjetar, volumin më të madh të materialit statistikor e përbëjnë të dhënat për gjykatat të trajtuar në dy kapituj kryesor, për çështjet penale dhe civile në shkallë vendi si dhe një kapitull për të dhënat analitike të volumit të punës, natyrës së çështjeve të përfunduara dhe modës së tyre për çdo gjykatë të veçantë. Informacioni me të dhënat e prokurorisë, përmbarimit, burgjeve është aksesiv por tepër i domosdoshëm për të plotësuar tërësinë e të dhënave në fushën juridike.

### **➤ Disa nga konceptet statistikor më të përdorura**

**Me grupim** kuptojmë ndarjen e masës në grupe homogjene nga pikëpamja cilësore. Grupimi bëhet në klasa të cilat duhet të përmbajnë tipe të ngjashme të kolektivitetit në aspektin cilësor dhe si rregull me numër të barabart elementësh. Për natyrën që ka statistika juridike ndarja në klasa me numër të njëjtë elementësh është e pa mundur sepse krimet me kundërvajtjet penale që paraqesin ndryshimet cilësore nuk janë në numër të barabartë, gjithashtu kapituj të ndryshëm të kodit penal shoqërohen me numër jo të barabartë veprash penale. Për të shmangur këtë “anomali” përdoret koncepti i mesatares aritmetike dhe mesatares së ponderuar.

**Grupimi mund të jetë kualitativ** atëherë kur shprehet me fjalë p.sh. krime, kundërvajtje, familjare, tregtare, administrative etj.

**Grupim kuantitativ** atëherë kur shprehet me të dhëna që përbajnë si p.sh. masë e dënimit, kohëzgjatja e gjykimit etj.

**Modë** quhet ajo vlerë e zgjedhjes që ka dendurinë më të madhe. E shprehur me fjalë të tjera moda tregon dukurinë më të shpeshtë në raport me fenomenet e tjera dhe e llogaritur për njësinë e vrojtimit. Në qoftë se të dhënat janë paraqitur në klasa, atëherë klasa me dendurinë më të madhe quhet klasë modale. Mund të ndodhë që të kemi më tepër se një klasë modale dhe raste të tilla kemi në disa

rrethe gjyqësore ku p.sh. moda janë krimet kundër jetës dhe kundër rendit dhe sigurisë publike si dhe kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike p.sh. në Shkodër , Vlorë etj.

**Koeficienti i kriminalitetit** tregon numrin e krimeve për 10 mijë apo 100 mijë banorë. Në këtë rast konkludohet më saktë për shpërndarjen e krimit në vend. Ky parametër shërben për të përcaktuar numrin e krimeve ose veprave penale të konsumuara duke i vënë këta në raport ideal me numrin e popullsisë së mjedisit shoqëror ku kryhet kjo vepër penale dhe për të cilin është dhënë një vendim përfundimtar. Në rritjen e këtij koeficienti sidomos për rrethet bregdetare apo kufitare ndikon edhe eksportimi i krimit.

Botimin e Vjetarit Statistikor për vitin 2006 do ta gjeni edhe në rrugë elektronike në sitin e Ministrisë së Drejtësisë , në Drejtorinë e Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë në adresën : [www.justice.gov.al](http://www.justice.gov.al).

# K R E U

# 1

STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET  
PENALE & CIVILE  
TË GJYKUARANGA GJYKATAT  
E SHKALLËS SË PARË


## STATISTIKA PËR ÇËSHTJET PENALE DHE CIVILE TË GJYKUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË.

( Statistics for Criminal and Civil cases examined by District courts)

Gjatë vitit 2006 janë shqyrtuar gjithsej **60073** çështje penale dhe civile nga 58149 çështje të shqyrtuara në vitin 2005, 48823 çështje të shqyrtuara në vitin 2004, 45899 në vitin 2003 dhe 43884 çështje të shqyrtuara në vitin 2002.

Në mënyrë tabelare dhe grafike kemi panoramën si më poshtë :

| Periudha<br>(Period) | Çështje Penale<br>(Criminal cases) | Çështje Civile<br>(Civil cases) | Gjithsej<br>(Total) |
|----------------------|------------------------------------|---------------------------------|---------------------|
| Viti (Year) 2002     | 5466                               | 33573                           | 38364               |
| Viti (Year)2003      | 5702                               | 40197                           | 45899               |
| Viti (Year)2004      | 7068                               | 41755                           | 48823               |
| Viti (Year)2005      | 6796                               | 51353                           | 58149               |
| Viti (Year)2006      | 7088                               | 52985                           | 60073               |




## STATISTIKA PËR ÇËSHTJET PENALE TË GJYKUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË SHPREHURA NË PËRQINDJE

( Statistics for Criminal cases examined by District courts indicated in percentage)

Gjatë vitit 2006 janë regjistruar në total **9099** çështje penale, nga të cilat **8221** çështje penale sipas Kodit Penal (civil) dhe **878** çështje penale sipas Kodit Penal Ushtarak.

Kanë përfunduar **7088** çështje penale, ku **6411** sipas K.P.C. dhe **677** sipas K.P.U. dhe kanë mbetur pa përfunduar **2011** çështje penale, nga të cilat **1810** sipas K.P.C. dhe **201** sipas K.P.U.

| Periudha<br>(Period) | Çështje Penale<br>(Criminal cases) | Përqindja<br>(Percentage) |
|----------------------|------------------------------------|---------------------------|
| Viti (Year) 2002     | 5466                               | 17 %                      |
| Viti (Year) 2003     | 5702                               | 18 %                      |
| Viti (Year) 2004     | 7068                               | 22 %                      |
| Viti (Year) 2005     | 6796                               | 21%                       |
| Viti (Year) 2006     | 7088                               | 22%                       |



**DINAMIKA E ÇËSHTJEVE PENALE**  
**(Dynamics of Criminal cases in 2006)**

| Gjykata e Rrethit<br>Gjyqësor | Çështje te<br>mbartura | Ardhur te reja | Ardhur pas<br>prishjes   | Ardhur pas<br>rihetimit           | Gjithsej    |
|-------------------------------|------------------------|----------------|--------------------------|-----------------------------------|-------------|
| (District courts)             | (Pending cases)        | (New cases)    | (Cases to be<br>retried) | (Cases to be re-<br>investigated) | (Total)     |
| Berat                         | 46                     | 210            | 5                        | 0                                 | 261         |
| Bulqizë                       | 12                     | 50             | 0                        | 0                                 | 62          |
| Dibër                         | 18                     | 63             | 3                        | 0                                 | 84          |
| Durrës                        | 161                    | 687            | 7                        | 0                                 | 855         |
| Elbasan                       | 55                     | 325            | 1                        | 0                                 | 381         |
| Fier                          | 109                    | 276            | 15                       | 0                                 | 400         |
| Gramsh                        | 4                      | 41             | 0                        | 0                                 | 45          |
| Gjirokaster                   | 64                     | 210            | 1                        | 0                                 | 275         |
| Kavajë                        | 16                     | 109            | 1                        | 0                                 | 126         |
| Kolonjë                       | 4                      | 30             | 0                        | 0                                 | 34          |
| Korçë                         | 38                     | 374            | 0                        | 5                                 | 417         |
| Krujë                         | 39                     | 164            | 4                        | 0                                 | 207         |
| Kukës                         | 25                     | 97             | 6                        | 0                                 | 128         |
| Kurbin                        | 69                     | 196            | 12                       | 0                                 | 277         |
| Lezhë                         | 74                     | 178            | 0                        | 0                                 | 252         |
| Librazhd                      | 14                     | 93             | 2                        | 0                                 | 109         |
| Lushnje                       | 103                    | 186            | 8                        | 0                                 | 297         |
| Mat                           | 31                     | 82             | 0                        | 0                                 | 113         |
| Mirditë                       | 24                     | 32             | 2                        | 0                                 | 58          |
| Permet                        | 4                      | 51             | 1                        | 0                                 | 56          |
| Pogradec                      | 28                     | 171            | 3                        | 0                                 | 202         |
| Pukë                          | 26                     | 100            | 2                        | 0                                 | 128         |
| Sarandë                       | 17                     | 108            | 3                        | 0                                 | 128         |
| Skrapar                       | 3                      | 37             | 0                        | 0                                 | 40          |
| Shkodër                       | 99                     | 393            | 16                       | 2                                 | 510         |
| Tepelenë                      | 6                      | 38             | 0                        | 0                                 | 44          |
| Tiranë                        | 414                    | 1392           | 52                       | 13                                | 1871        |
| Tropojë                       | 14                     | 90             | 0                        | 0                                 | 104         |
| Vlorë                         | 228                    | 390            | 13                       | 3                                 | 634         |
| Krimet e rënda                | 65                     | 57             | 1                        | 0                                 | 123         |
| <b>T O T A L I</b>            | <b>1810</b>            | <b>6230</b>    | <b>158</b>               | <b>23</b>                         | <b>8221</b> |

**MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE PENALE**  
**(Way of termination for criminal cases)**

| Gjykata<br>e<br>Rrethit Gjyqësor<br>(District courts) | Me<br>vendim<br>Fajësie<br>(By plea of<br>guilty) | Me<br>vendim<br>Pafajësie<br>(By plea<br>of not) | Çështje<br>të<br>pushuara<br>(Ceased<br>cases) | Kthyerat<br>për<br>plotësim<br>hetimesh<br>(Cases to<br>be<br>re-<br>investigate) | Vendosur<br>inkompetenca<br>(Lack of<br>competence) | SHUMA<br>(Total) |
|-------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|--------------------------------------------------|------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|------------------|
| Berat                                                 | 171                                               | 2                                                | 30                                             | 1                                                                                 | 0                                                   | 204              |
| Bulqizë                                               | 42                                                | 3                                                | 11                                             | 0                                                                                 | 0                                                   | 56               |
| Dibër                                                 | 54                                                | 3                                                | 4                                              | 3                                                                                 | 0                                                   | 64               |
| Durrës                                                | 635                                               | 10                                               | 67                                             | 2                                                                                 | 1                                                   | 715              |
| Elbasan                                               | 247                                               | 7                                                | 63                                             | 4                                                                                 | 3                                                   | 324              |
| Fier                                                  | 248                                               | 5                                                | 40                                             | 2                                                                                 | 5                                                   | 300              |
| Gramsh                                                | 20                                                | 1                                                | 15                                             | 0                                                                                 | 0                                                   | 36               |
| Gjirokastrë                                           | 159                                               | 10                                               | 27                                             | 4                                                                                 | 0                                                   | 200              |
| Kavajë                                                | 85                                                | 4                                                | 12                                             | 3                                                                                 | 0                                                   | 104              |
| Kolonjë                                               | 27                                                | 2                                                | 1                                              | 0                                                                                 | 0                                                   | 30               |
| Korçë                                                 | 276                                               | 7                                                | 43                                             | 4                                                                                 | 2                                                   | 332              |
| Krujë                                                 | 153                                               | 2                                                | 15                                             | 3                                                                                 | 0                                                   | 173              |
| Kukës                                                 | 97                                                | 1                                                | 10                                             | 0                                                                                 | 0                                                   | 108              |
| Kurbini                                               | 179                                               | 8                                                | 17                                             | 3                                                                                 | 1                                                   | 208              |
| Lezhë                                                 | 184                                               | 8                                                | 22                                             | 1                                                                                 | 0                                                   | 215              |
| Librazhd                                              | 49                                                | 10                                               | 28                                             | 2                                                                                 | 0                                                   | 89               |
| Lushnjë                                               | 183                                               | 8                                                | 23                                             | 5                                                                                 | 3                                                   | 222              |
| Mat                                                   | 56                                                | 9                                                | 23                                             | 4                                                                                 | 1                                                   | 93               |
| Mirditë                                               | 40                                                | 3                                                | 5                                              | 0                                                                                 | 1                                                   | 49               |
| Përmet                                                | 31                                                | 1                                                | 14                                             | 1                                                                                 | 1                                                   | 48               |
| Pogradec                                              | 132                                               | 3                                                | 31                                             | 1                                                                                 | 0                                                   | 167              |
| Pukë                                                  | 69                                                | 4                                                | 26                                             | 0                                                                                 | 0                                                   | 99               |
| Sarandë                                               | 86                                                | 7                                                | 11                                             | 1                                                                                 | 0                                                   | 105              |
| Skrapar                                               | 22                                                | 2                                                | 5                                              | 2                                                                                 | 0                                                   | 31               |
| Shkodër                                               | 358                                               | 22                                               | 15                                             | 17                                                                                | 1                                                   | 413              |
| Tepelenë                                              | 27                                                | 1                                                | 3                                              | 0                                                                                 | 0                                                   | 31               |
| Tiranë                                                | 1261                                              | 57                                               | 41                                             | 14                                                                                | 2                                                   | 1375             |
| Tropojë                                               | 81                                                | 3                                                | 1                                              | 0                                                                                 | 0                                                   | 85               |
| Vlorë                                                 | 420                                               | 13                                               | 28                                             | 12                                                                                | 1                                                   | 474              |
| Krimet e Rënda                                        | 51                                                | 2                                                | 1                                              | 4                                                                                 | 3                                                   | 61               |
| <b>T O T A L I</b>                                    | <b>5443</b>                                       | <b>218</b>                                       | <b>632</b>                                     | <b>93</b>                                                                         | <b>25</b>                                           | <b>6411</b>      |

**ÇËSHTJET PENALE SIPAS RRETHEVE**  
**(Criminal cases examined by district courts in 2006)**


| Gjykata e Rrethit<br>Gjyqësor<br>(District courts) | Gjithsej për<br>gjykim<br>(Total) | Përfunduar<br>(Examined) | Pa Përfunduar<br>(Pending) |
|----------------------------------------------------|-----------------------------------|--------------------------|----------------------------|
| Berat                                              | 261                               | 204                      | 57                         |
| Bulqizë                                            | 62                                | 56                       | 6                          |
| Dibër                                              | 84                                | 64                       | 20                         |
| Durrës                                             | 855                               | 715                      | 140                        |
| Elbasan                                            | 381                               | 324                      | 57                         |
| Fier                                               | 400                               | 300                      | 100                        |
| Gramsh                                             | 45                                | 36                       | 9                          |
| Gjirokastrë                                        | 275                               | 200                      | 75                         |
| Kavajë                                             | 126                               | 104                      | 22                         |
| Kolonjë                                            | 34                                | 30                       | 4                          |
| Korcë                                              | 417                               | 332                      | 85                         |
| Krujë                                              | 207                               | 173                      | 34                         |
| Kukës                                              | 128                               | 108                      | 20                         |
| Kurbin                                             | 277                               | 208                      | 69                         |
| Lezhë                                              | 252                               | 215                      | 37                         |
| Librazhd                                           | 109                               | 89                       | 20                         |
| Lushnjë                                            | 297                               | 222                      | 75                         |
| Mat                                                | 113                               | 93                       | 20                         |
| Mirditë                                            | 58                                | 49                       | 9                          |
| Permet                                             | 56                                | 48                       | 8                          |
| Pogradec                                           | 202                               | 167                      | 35                         |
| Pukë                                               | 128                               | 99                       | 29                         |
| Sarandë                                            | 128                               | 105                      | 23                         |
| Skrapar                                            | 40                                | 31                       | 9                          |
| Shkodër                                            | 510                               | 413                      | 97                         |
| Tepelenë                                           | 44                                | 31                       | 13                         |
| Tiranë                                             | 1871                              | 1375                     | 496                        |
| Tropojë                                            | 104                               | 85                       | 19                         |
| Vlorë                                              | 634                               | 474                      | 160                        |
| Krimet e rënda                                     | 123                               | 61                       | 62                         |
| <b>T O T A L I</b>                                 | <b>8221</b>                       | <b>6411</b>              | <b>1810</b>                |



### ÇËSHTJE PENALE GJITHSEJ TË GJYKUARA PËR VITIN 2006 (Total Criminal cases examined for the year 2006)

Meqënëse të dhënat e mëposhteme paraqesin volumin e punës së gjykatave për rrethet gjyqësore që gjykojnë edhe çështjet ushtarake të dhënat për këto çështje janë llogaritur në totalin e të dhënave të rretheve si vijon: Tiranë (1375 + 298); Shkodër (413 +57); Vlorë (474 +184) Korçë (332 +76) dhe Gjirokastrë (200 +62).


| Gjykata<br>e<br>Rrethit Gjyqësor<br>(District courts) | Përfunduar<br>(Terminated cases) |
|-------------------------------------------------------|----------------------------------|
| Berat                                                 | 204                              |
| Bulqizë                                               | 56                               |
| Dibër                                                 | 64                               |
| Durrës                                                | 715                              |
| Elbasan                                               | 324                              |
| Fier                                                  | 300                              |
| Gramsh                                                | 36                               |
| Gjirokastrë                                           | 262                              |
| Kavajë                                                | 104                              |
| Kolonjë                                               | 30                               |
| Korcë                                                 | 408                              |
| Krujë                                                 | 173                              |
| Kukës                                                 | 108                              |
| Kurbin                                                | 208                              |
| Lezhë                                                 | 215                              |
| Librazhd                                              | 89                               |
| Lushnje                                               | 222                              |
| Mat                                                   | 93                               |
| Mirditë                                               | 49                               |
| Permet                                                | 48                               |
| Pogradec                                              | 167                              |
| Pukë                                                  | 99                               |
| Sarandë                                               | 105                              |
| Skrapar                                               | 31                               |
| Shkodër                                               | 470                              |
| Tepelenë                                              | 31                               |
| Tiranë                                                | 1673                             |
| Tropojë                                               | 85                               |
| Vlorë                                                 | 658                              |
| Krimet e Rënda                                        | 61                               |
| <b>T O T A L I</b>                                    | <b>7088</b>                      |



**SERIA DINAMIKE E KËRKESAVE PENALE SIPAS GJYKATAVE  
TË RRETHEVE**

**(Dynamics of Criminal requests according to district courts)**

| <b>Gjykata<br/>e<br/>Rrethit Gjyqësor<br/>(District courts)</b> | <b>Kërkesa Penale ( gjithsej )<br/>(A total of criminal requests )</b> |
|-----------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|
| Berat                                                           | 245                                                                    |
| Bulqizë                                                         | 69                                                                     |
| Dibër                                                           | 128                                                                    |
| Durrës                                                          | 1046                                                                   |
| Elbasan                                                         | 1867                                                                   |
| Fier                                                            | 389                                                                    |
| Gramsh                                                          | 20                                                                     |
| Gjirokastrë                                                     | 181                                                                    |
| Kavajë                                                          | 635                                                                    |
| Kolonjë                                                         | 41                                                                     |
| Korcë                                                           | 637                                                                    |
| Krujë                                                           | 662                                                                    |
| Kukës                                                           | 128                                                                    |
| Kurbin                                                          | 177                                                                    |
| Lezhë                                                           | 670                                                                    |
| Librazhd                                                        | 97                                                                     |
| Lushnje                                                         | 216                                                                    |
